

VENDIM
Nr. 21, datë 13.3.2019

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR ZOTËRIMIN NGA BANKA UNION
SHA TË 100 PËR QIND TË KAPITALIT AKSIONAR TË BANKËS
NDËRKOMBËTARE TREGTARE SHA**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e” të nenit 43 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të shkronjës “gj” të pikës 1 të nenit 24, si dhe të nenit 25 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për zotërimin e 100 për qind të aksioneve me të drejtë vote, të kapitalit aksionar të Banka Ndërkombëtare Tregtare sh.a. nga Banka Union sh.a.
2. Ngarkohet Banka Union sh.a. të njoftojë Bankën e Shqipërisë për përmbushjen nga palët të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të kontratës për shitblerjen e aksioneve.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gent Sejko